



REPUBLIKA E KOSOVËS - РЕПУБЛИКА КОСОВО - REPUBLIC OF KOSOVO  
GJYKATA KUSHTETUESE  
УСТАВНИ СУД  
CONSTITUTIONAL COURT

Prishtinë, më 19 mars 2012  
Nr. ref.: RK 208/12

## AKTVENDIM PËR PAPRANUESHMËRI

në

**Rastin nr. KO 05/12**

Parashtrues

**Visar Ymeri dhe dymbëdhjetë deputetë të tjerë të  
Kuvendit të Republikës së Kosovës**

**Lidhur me kushtetutshmërinë e Vendimit të Kuvendit të Republikës së  
Kosovës, Nr. 04-V-279, të 20 janarit 2012.**

### GJYKATA KUSHTETUESE E REPUBLIKËS SË KOSOVËS

e përbërë nga:

Enver Hasani, Kryetar  
Kadri Kryeziu, Zëvendëskryetar  
Robert Carolan, gjyqtar  
Altay Suroy, gjyqtar  
Almiro Rodrigues, gjyqtar  
Snezhana Botusharova, gjyqtare  
Ivan Čukalović, gjyqtar  
Gjylieta Mushkolaj, gjyqtare dhe  
Iliriana Islami, gjyqtare

#### Parashtrues

1. Parashtrues të kërkesës janë: Visar Ymeri, Rexhep Selimi, Liburn Aliu, Albin Kurti, Albana Fetoshi, Glauk Konjufca, Albana Gashi, Florin Krasniqi, Alma Lama, Albulena Haxhiu, Afrim Kasolli, Emin Gërbeshi dhe Afrim Hoti, që të gjithë deputetë të Kuvendit të Republikës së Kosovës.

## **Objekti i çështjes**

2. Parashtruesit e kontestojnë kushtetutshmërinë e Vendimit të Kuvendit të Republikës së Kosovës, Nr. 04-V-279, të 20 janarit 2012. Ky vendim u publikua të njëjtën ditë në ueb faqen e Kuvendit.

## **Baza juridike**

3. Neni 113.5 i Kushtetutës së Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejme: Kushtetuta), neni 38 i Ligjit për Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejme: Ligji), dhe rregulli 36 i Rregullores së punës së Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejme: Rregullorja e punës).

## **Procedura në Gjykatë**

4. Parashtruesit e dorëzuan kërkesën në Gjykatën Kushtetuese (në tekstin e mëtejme: Gjykata) më 26 janar 2012.
5. Më 31 janar 2012, Kryetari e caktoi gjyqtaren Snezhana Botusharova Gjyqtare raportuese dhe Kolegjin shqyrtues të përbërë nga gjyqtarët Robert Carolan (kryesues), Altay Suroy dhe Ivan Čukalović.
6. Më 31 janar 2012, Gjykata Kushtetuese i njoftoi Kryetarin e Kuvendit dhe Qeverinë për parashtrimin e kësaj kërkesë.
7. Më 7 shkurt 2012, Gjykata u shkroi letër parashtruesve me anë të së cilës kërkonte sqarim lidhur me kërkesën.
8. Një kopje e letrës së Gjykatës iu dërgua Kryetarit të Kuvendit dhe Qeverisë.
9. Parashtruesit iu përgjigjën letrës së Gjykatës përmes letrës së 20 shkurtit 2012, të cilën Gjykata e mori më 21 shkurt 2012. Përgjigja e parashtruesve përshkruhet më në detaje në paragrafët 18 deri në 22 më poshtë.
10. Një kopje e kësaj përgjigjeje iu dërgua Kryetarit të Kuvendit dhe Qeverisë më 27 shkurt 2012, dhe u ftuan të përgjigjeshin brenda një jave, po të dëshironin. Gjykata nuk mori asnjë përgjigje brenda kësaj kohe.
11. Kolegji shqyrtues e shqyrtoi raportin e përgatitur nga Gjyqtarja raportuese më 15 mars 2012, i cili i rekomandoi Gjykatës në përbërje të plotë për papranueshmëri të kërkesës. Gjykata në përbërje të plotë e shqyrtoi kërkesën të njëjtën ditë.

## **Përmbledhja e fakteve**

12. Më 20 janar 2012, Kuvendi e shqyrtoi një mocion të paraqitur nga Grupi Parlamentar i Partisë Demokratike të Kosovës (PDK) dhe nxori një vendim po atë ditë. Vendimi, ndër të tjera, “mirëpriti marrëveshjet” e arritura në dialogun ndërmjet Qeverisë së Republikës së Kosovës dhe Republikës së Serbisë, dhe se Kuvendi “e mbështeste zbatimin e tyre të tërësishëm”.
13. Prej deputetëve të pranishëm, 59 votuan për mocion, 41 ishin kundër, dhe një abstenoï.

## Argumentet e paraqitura nga parashtruesit

14. Parashtruesit theksojnë në kërkesën e tyre se vendimi i Kuvendit u referohet marrëveshjeve të arritura ndërmjet Qeverisë së Republikës së Kosovës dhe Republikës së Serbisë, të cilat, siç pohojnë, janë dy shtete me subjektivitet juridik në të drejtën ndërkombëtare.
15. Parashtruesit theksojnë se Ligji për marrëveshjet ndërkombëtare, Nr. 04/L-052, në nenin 3.1.5, e përkufizon marrëveshjen ndërkombëtare si “- një marrëveshje ndërkombëtare përkatësisht traktat i lidhur ndërmjet Republikës së Kosovës dhe shteteve të huaja ose organizatave ndërkombëtare në formë të shkruar, e rregulluar me të drejtën ndërkombëtare pavarësisht nga emërtimi dhe nga përfshirja në një, dy apo më shumë instrumente të ndërlidhura.” Si rrjedhojë, ata pohojnë se pasi marrëveshjet e përmendura në paragrafin 1 të vendimit të Kuvendit, të 20 janarit 2012, janë lidhur ndërmjet dy shteteve në pajtim me atë ligj, ato janë marrëveshje ndërkombëtare.
16. Parashtruesit e citojnë në tërësi nenin 18 të Kushtetutës lidhur me ratifikimin e marrëveshjeve ndërkombëtare. Ata theksuan që “Në këtë mënyrë, përmes ‘mirëpritjes së arritjes së marrëveshjeve’ dhe përmes ‘mbështetjes për zbatim të tërësishëm’ të tyre, Kuvendi i Republikës së Kosovës i ka njohur dhe i ka ratifikuar këto marrëveshje si dhe ka marr përsipër detyrimet që dalin nga këto marrëveshje”.
17. Ata pohojnë që ky “ratifikim i marrëveshjeve ndërkombëtare” ishte në kundërshtim me nenin 18 të Kushtetutës.
18. Më 7 shkurt 2012, Gjykata u shkroi letër parashtruesve me sa vijon:
  - 1) *Cili është thelbi i çështjes kushtetuese të ankesës, apo shkeljes së pretenduar, për të cilën ju konsideroni që kërkon shqyrtimin nga ana e Gjykatës Kushtetuese të substancës apo procedurës së saj.*
  - 2) *Ju lutem të cekni se mbi çfarë baze konsideroni se objekti i çështjes së kërkesës i nënshtrohet proceseve të ratifikimit të përcaktuara në nenin 18 të Kushtetutës së Kosovës dhe të ofroni prova që do të mbështesnin një bazë të tillë.*
19. Në përgjigjen e tyre, parashtruesit përsëritën qëndrimin që kishin marrë në kërkesë dhe përsëri iu referuan “mirëpritjes së arritjes së marrëveshjeve” dhe “mbështetjes së zbatimit të tërësishëm të këtyre marrëveshjeve”. Ata theksuan se vendimi i nxjerrë nga Kuvendi i “ratifikoi” marrëveshjet ndërkombëtare. Ata konsideronin se ratifikimi nënkuptonte që duhej të zbatohet procedura e parashikuar me nenin 18 të Kushtetutës.
20. Ata i përmendën kriteret e ndryshme të ratifikimit sipas nenit 18.1 dhe nenit 18.2; njëri kërkonte dy të tretat e shumicës së deputetëve të Kuvendit dhe tjetri kërkonte ratifikimin nga Presidenti i Republikës së Kosovës, varësisht nga objekti i çështjes së marrëveshjeve.
21. Përveç kësaj, ata e shtjelluan dhe e analizuan karakterin e marrëveshjeve ndërkombëtare në bazë të Ligjit për marrëveshjet ndërkombëtare, Nr. 04. L-052, dhe Konventës së Vjenës për të Drejtën e Traktateve të vitit 1969.
22. Parashtruesit gjithashtu përsëritën që Republika e Kosovës dhe Republika e Serbisë janë dy vende me subjektivitet juridik në të drejtën ndërkombëtare. Prandaj, ata pohojnë që marrëveshjet të cilat përmenden në vendimin e Kuvendit kishin karakter të

marrëveshjeve ndërkombëtare, siç parashikohet me Ligjin për marrëveshjet ndërkombëtare dhe Konventën e Vjenës për të Drejtën e Traktateve të vitit 1969.

23. Në përgjigjen e tyre, parashtruesit kërkuan që *“Presidenti, Kuvendi dhe Kryeministri duhet të udhëzohen për obligimet e tyre kushtetuese lidhur me nënshkrimin e marrëveshjeve ndërkombëtare (...)”*.

### **Vlerësimi i pranueshmërisë së kërkesës**

24. Për të përcaktuar nëse kërkesa mund të shqyrtohet nga Gjykata Kushtetuese, duhet të bëhet vlerësimi nëse ajo është apo nuk është e pranueshme.

25. Parashtruesit e parashtruan kërkesën e tyre në përputhje me nenin 113.5 të Kushtetutës, i cili thotë:

*“Dhjetë (10) a më shumë deputetë të Kuvendit të Kosovës, brenda një afati prej tetë (8) ditësh nga dita e miratimit, kanë të drejtë të kontestojnë kushtetutshmërinë e çfarëdo ligji ose vendimi të miratuar nga Kuvendi, si për përmbajtjen, ashtu edhe për procedurën e ndjekur\*.”*

26. Kërkesa u parashtrua nga 13 deputetë të Kuvendit të Kosovës, siç përcaktohet në paragrafin 1 më sipër, që është më tepër se minimumi që kërkohet me nenin 113.5 të Kushtetutës, prandaj kriteri për palë të autorizuar është përmbushur.

27. Vendimi i Kuvendit, të cilin parashtruesit e kontestojnë, u mor më 20 janar 2012 dhe kërkesa u parashtrua në Gjykatë më 26 janar 2012, dmth. brenda afatit prej tetë ditësh të përcaktuar me Kushtetutë. Prandaj, kërkesa është parashtruar me kohë.

28. Mirëpo, ka edhe çështje të tjera që Gjykata do të marrë parasysh me rastin e përcaktimit nëse kërkesa është apo nuk është e pranueshme. Në këtë drejtim, duhet t'i kushtohet vëmendje formulimit të nenit 113.5, i cili përcakton që *“kushtetutshmëria e një ligji apo vendimi të miratuar nga Kuvendi si për përmbajtjen, ashtu edhe për procedurën e ndjekur”*, është ajo që do të shqyrtohet nga Gjykata.

29. Gjithashtu është me rëndësi të theksohen dispozitat përkatëse të Ligjit me të cilin rregullohet parashtrimi i kërkesës sipas nenit 113.5 të Kushtetutës. Në këtë drejtim, neni 42 i Ligjit thotë:

### **Neni 42 Saktësimi i kërkesës**

*1. Në kërkesën e ngritur në pajtim me nenin 113, paragrafi 6\* të Kushtetutës, ndër të tjera, paraqiten informatat e mëposhtme:*

*1.1. emrat dhe nënshkrimet e të gjithë deputetëve të Kuvendit që kontestojnë kushtetutshmërinë e ligjit apo vendimit të nxjerrë nga ana e Kuvendit të Republikës së Kosovës;*

*1.2. dispozitat e Kushtetutës apo të ndonjë akti apo ligji që ka të bëjë me këtë kërkesë\*;  
dhe*

---

\* Versioni në gjuhën serbe dallon nga versioni në gjuhën shqipe dhe angleze.

† Versioni në gjuhën shqipe dhe serbe dallon nga versioni në gjuhën angleze.

\* Versioni në gjuhën serbe dallon nga versioni në gjuhën shqipe dhe angleze.

*1.3. paraqitjen e provave mbi të cila mbështetet kontesti.*

30. Rikujtojmë, Gjykata veçanërisht kërkoi që parashtruesit ta identifikonin thelbin e çështjes kushtetuese që kërkonte shqyrtim nga Gjykata lidhur me substancën apo procedurën e saj. Nga parashtruesit gjithashtu u kërkua veçanërisht të ofronin prova që do ta mbështetnin bazën mbi të cilën konsideronin se objekti i çështjes së kërkesës u nënshtrohej proceseve të ratifikimit të përcaktuara në nenin 18 të Kushtetutës. Kërkesa e parashtruesve ishte arsyetuar në veçanti sipas nenit 42.1.3 të Ligjit.
31. Gjykata rikujton që Kuvendi i Kosovës, në vendimin e 20 janarit 2012, *“mirëpret Marrëveshjet e arritura në mes të Qeverisë së Republikës së Kosovës dhe Republikës së Serbisë, përmes procesit të dialogut dhe mbështetë zbatimin e tyre të tërësishëm”*. Vendimi gjithashtu theksoi se *“Qeveria e Kosovës duhet të vendosë për masat përkatëse reciproke për mbarëvajtjen e procesit të dialogut dhe zbatimin e konkluzioneve të arritura”*, dhe se *“Qeveria obligohet t’i raportojë Kuvendit lidhur me mbarëvajtjen e procesit të dialogut dhe reciprocitetit”*.
32. Sipas nenit 65 (1) të Kushtetutës [Kompetencat e Kuvendit], Kuvendi miraton ligje, rezoluta dhe akte të tjera të përgjithshme të nxjerra brenda kompetencave të veta dhe të miratuara me kuorum dhe shumicë të nevojshme, siç kërkohet me nenin 69 (3) dhe nenin 80 (1) të Kushtetutës.
33. Gjykata vëren që Kuvendi i Republikës së Kosovës ka të drejtë ta vendosë formën e akteve që i miraton. Në këtë rast, Kuvendi e kishte miratuar një vendim pas mocionit të propozuar nga anëtarët e një grupi parlamentar. Parashtruesit nuk e ngrenë çështjen nëse ka pasur kuorum, siç parashihet me nenin 69.3, apo shumicë, siç parashihet me nenin 80.1 të Kushtetutës, me rastin e marrjes së vendimit. Nga parashtruesit duket që ata nuk e sulmojnë substancën apo procedurën e vendimit të Kuvendit, por më tepër natyrën e tij. Duket që ata duan të thonë që Gjykata, në këtë rast, do të duhej ta ndryshonte natyrën e vendimit, por nuk ofrojnë argumente, prova, apo arsyetim se si Gjykata mund ta bëjë këtë. Parashtruesit pohojnë që vendimi i Kuvendit përmban marrëveshje ndërkombëtare dhe prandaj ky ishte një ratifikim që kërkonte zbatimin e nenit 18 të Kushtetutës. Në Kuvend nuk u propozua apo diskutua që mocioni që gjendej para tij përmbante marrëveshje ndërkombëtare apo që vendimi i miratuar duhej të ratifikohet sipas nenit 18.
34. Nuk ka argumente apo prova që ajo që ishte në pyetje në vendimin e nxjerrë nga Kuvendi bie nën fushëveprimin e nenit 18. Për më tepër, parashtruesit nuk i kanë shtjelluar dallimet ndërmjet nenit 18.1 dhe 18.2, dhe cili do të duhej të zbatohet. Vetëm përmendja e nenit 18 në tërësinë e tij nuk shpie në konkluzionin se ai duhej të zbatohet në vendimin e Kuvendit.
35. Gjykata përsërit që kompetencë e saj kushtetuese është ta shqyrtojë kushtetutshmërinë e vendimit të kontestuar lidhur me substancën e tij dhe procedurën zbatuar. Parashtruesit nuk e kontestojnë as substancën as procedurën e vendimit të nxjerrë. Ata pohojnë që Kuvendi është dashur ta ketë miratuar një procedurë të ratifikimit sipas nenit 18 të Kushtetutës.
36. Gjykata duhet ta analizojë tërësinë e kërkesës së parashtruar nga parashtruesit dhe kjo kërkon që të merren parasysh parashtrimi i kërkesës së parë dhe përgjigja që parashtruesit e kishin dorëzuar në Gjykatë më 21 shkurt 2012. Në esencë, duket të parashtruesit dëshirojnë që Gjykata ta interpretojë vendimin e Kuvendit, të 20 janarit 2012, si marrëveshje ndërkombëtare që kërkon ratifikim sipas nenit 18 të Kushtetutës. Gjykata është e vetëdijshme për doktrinën e ndarjes së pushteteve, siç parashihet në nenin 4 të Kushtetutës, dhe për kompetencat e Kuvendit. Prandaj, Gjykata konsideron

që është detyrë e Kuvendit të marrë vendime të tilla që i konsideron të duhura apo të nevojshme. Si rrjedhojë, kërkesa e parashtruesve që Gjykata ta konsiderojë vendimin e Kuvendit si marrëveshje ndërkombëtare që kërkon ratifikim është jashtë fushës së juridiksionit të Gjykatës sipas nenit 113.5 të Kushtetutës.

37. Prandaj, duke pasur parasysh të gjitha këto çështje, Gjykata konkludon që kërkesa është e papranueshme sepse nuk është *ratione materiae* në pajtim me Kushtetutën.

### PËR KËTO ARSYE

Në pajtim me nenin 113.5 të Kushtetutës, nenin 20 të Ligjit dhe rregullin 36 të Rregullores së punës, Gjykata Kushtetuese:

### VENDOS

- I. Njëzëri, ta hedhë poshtë kërkesën si të papranueshme;
- II. Me shumicë votash, ta hedhë poshtë kërkesën si të papranueshme sepse nuk është *ratione materiae* në pajtim me Kushtetutën;
- III. Ky Vendim do t'u komunikohet parashtruesve, Kryetarit të Kuvendit të Kosovës dhe Qeverisë së Kosovës;
- IV. Ky Vendim do të publikohet në Gazetën Zyrtare në pajtim me nenin 20 (4) të Ligjit; dhe
- III. Ky Vendim hyn në fuqi menjëherë.


Gjyqtarja raportuese



Snezhana Botusharova



Kryetari i Gjykatës Kushtetuese



Prof. Dr. Enver Hasani